



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 77, datë 12.07.2022

PËR

MIRATIMIN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, QENDRËS MUZEORE Durrës (QMD), TË PRONËS ME EMËRTIMIN “VENDSTREHIM”, ME VENDODHJE NË LAGJEN NR. 1, RRUGA “TAULANTIA”, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 155 M², NË INVENTAR TË NDËRMARRJES RRUGA, PRONË E BASHKISË, PËR NJË AFAT 1 VIT, ME TË DREJTË PËRSËRITJE

Bazuar në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenin 901 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, VKM-në nr. 536, datë 01.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të bashkisë Durrës”, i ndryshuar, shkresës nr.1797 prot., datë 30.03.2022, ardhur nga Ministria e Kulturës, më lëndë: “Kërkesë për bashkëpunim”, sipas relacionit të përgatitur nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Miratimin për dhënie në përdorim, pa kundërshpërblim, Qendrës Muzeore Durrës (QMD), të pronës me emërtimin “vendstrehim”, me sipërfaqe të përgjithshme 155 m², nga kjo sipërfaqe nën objekt 95 m² dhe sipërfaqe funksionale 60 m², në inventar të Ndërmarrjes Rrugë, pronë e bashkisë, që mban nr. 256 të listës së pronave, transferuar me VKM nr. 536,


datë 01.05.2008, me vendodhje në lagjen nr. 1, Rruga “Taulantia”, ZK 8512, për t’u përdorur për magazinim të objekteve, në inventar të Qendrës Muzeore Durrës, për një afat 1 vit, me të drejtë përsëritje, sipas genplanit dhe kontratës bashkëlidhur vendimit dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Ndërmarrja Rruga.
3. Vendimi i Këshillit bashkiak nr. 58, datë 31.05.2022, “Për miratimin për dhënien në përdorim, pa kundërshtim, Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Kulturës Durrës, të pronës me emërtimin “vendstrehim”, me sipërfaqe të përgjithshme 155 m², nga kjo sipërfaqe nën objekt 95 m² dhe sipërfaqe funksionale 60 m², në inventar të Ndërmarrjes Rruga, pronë e bashkisë, që mban nr. 256 të listës së pronave, transferuar me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, me vendodhje në lagjen nr. 1, Rruga “Taulantia”, ZK 8512, për t’u përdorur për magazinim të objekteve të trashëgimisë kulturore, për një afat 1 vit, me të drejtë përsëritje”, për shkak se rezultoi se palë në këtë vendim, në cilësinë e huamarrësit, nuk duhet të ishte Drejtoria Rajonale e Monumenteve të Kulturës Durrës, por Qendra Muzeore Durrës (QMD), revokohet.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 13.07.2022






U E N T L A N
I OBJEKTIT "VENDSTREHIM" ADMINISTRUAR NGA
NDERMARJA "RRUGA", DURRES

Adresa: Lagja nr.1, Rruga "Taulantia", Z.K. 8512, vendstrehimi nr.256, brenda rrethimit te Muzeut Arkeologjik Durres

Planimetria vendstrehimit Sh 1: 150
Siperfaqja nen objekt e vendstrehimit = 95m²
Siperfaqja funksionale e vendstrehimit = 60m²




NDERMARRJA RRUGA
DREJTORI
Alion Hysko

Pergjegjesi i
sektorit te vendstrehimeve
Florence Hyska
Florence Hyska

Topografi
punoi: Florenc Zyfi

Planvendosja vendstrehimit Sh 1: 500





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

DREJTORIA LIGJORE

SEKTORI I PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. _____ Prot.

Durrës, më ____ / ____ / 2022

KONTRATË HUAPËRDORJE

NR.....DT.....2022

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, QENDRËS MUZEORE DURRËS (QMD), TË PRONËS ME EMËRTIMIN “VENDSTREHIM”, ME SIPËRFAQE TË PERGJITHSHME 155 M², NË INVENTAR TË NDËRMARRJES RRUGA, PRONË E BASHKISË DURRËS , PËR NJË AFAT 1 VIT, ME TË DREJTË PËRSËRITJE

Sot me dt. ____ 07.2022, në ambjentet e Bashkisë Durrës, sipas ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 901 e vijues të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, VKM-në nr. 536, datë 01.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike të shtetit, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, shkreses nr.1797 prot., datë 30.03.2022, ardhur nga Ministria e Kulturës, më lëndë: “Kërkesë për bashkëpunim”, lidhet kjo kontratë huapërdorje, me objekt dhënien në përdorim, pa kundërshtpërblim të pronës me emërtimin “vendstrehim”, me sipërfaqe të përgjithshme 155 m², nga kjo sipërfaqe nën objekt 95 m² dhe sipërfaqe funksionale 60 m², në inventar të Ndërmarrjes Rruga, pronë e Bashkisë Durrës, që mban nr. 256 të listës së pronave, transferuar me VKM-në nr. 536, datë 01.05.2008, me vendodhje në lagjen nr. 1, Rruga “Taulantia”, ZK 8512, me kushtet si më poshtë:

Huadhënës: Bashkia Durrës, përfaqësuar nga kryetar i bashkisë znj. Emirina Sako.

Huamarrës: Qendra Muzeore Durrës (QMD), përfaqësuar nga drejtori z. Alban Ramohitaj, me seli në lagjen nr. 1, Rruga “Taulantia”, Durrës.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME:

NENI 1

OBJEKTI

Objekti i kësaj kontrate është dhënia pa kundërshtpërblim, të pronës me emërtimin “vendstrehim”, me sipërfaqe të përgjithshme 155 m², nga kjo sipërfaqe nën objekt 95 m² dhe sipërfaqe funksionale 60

m²), në inventar të Ndërmarrjes Rruga, pronë e bashkisë, me vendodhje në lagjen nr. 1, Rruga "Taulantia", ZK 8512, Durrës.

NENI 2

QËLLIMI I PËRDORIMIT

- 2.1 Qëllimi i kësaj kontrate huapërdorje, është dhënia në gëzim të përkohshëm të pronës me emërtimin "vendstrehim", të përcaktuar në nenin 1, për t'u përdorur për magazinim të objekteve në inventar të Qendrës Muzeore Durrës.
- 2.2 Ky ambient nuk mund të përdoret, përveç destinacionit të përcaktuar në nenin 2, pika 2.1.

NENI 3

KOHËZGJATJA

- 3.1 Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 1 (një) vjeçare, me të drejtë përsëritje.
- 3.2 Kontrata nuk ripërtërihet pas kalimit të afatit njëvjeçar, pa miratimin e shprehur me shkrim të huadhënësit.

NENI 4

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E HUADHËNËSIT

- 4.1 "Huadhënësi" dorëzon pronën e përcaktuar në nenin 1.1 të kësaj kontrate, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate.
- 4.2 "Huadhënësi" ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e "huamarrësit".
- 4.3 "Huadhënësi" është i detyruar të garantojë huamarrësin për gëzimin e qetë të sendit, objekt i kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrejné pretendime për të drejtën e tyre mbi pronën.
- 4.4 "Huadhënësi" ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur huamarrësi shkel detyrimet, duke e njoftuar këtë të fundit 15 ditë përpara me shkrim.
- 4.5 "Huadhënësi" nuk është i detyruar të garantojë huamarrësin nga shqetësimet e të tretëve, që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.
- 4.6 Çdo njoftim apo shkresë e dërguar palës tjetër (huamarrësit) në adresën e mësipërme do të konsiderohet e marrë nga huamarrësi, me kushtin që dërguesi të disponojë mandatin postar të postës.
- 4.7 Në rast të ndryshimit të adresës nga njera palë, kjo e fundit detyrohet t'i komunikojë palës tjetër adresën e re. Në rast të kundërt komunikimet e dërguara në adresën e mëparshme konsiderohen të vlefshme.
- 4.8 Në çdo rast, bashkia (huadhënësi) ka të drejtë që të bëjë njoftime me shpallje publike në stendën e bashkisë, në Njësinë nr.1 dhe në ambientin objekt kontrate huapërdorje. Shpallja qëndron 5 ditë e

afishuar, dhe pas plotësimit të afatit 5 ditor njoftimi konsiderohet i marrë rregullisht dhe i njohur për palën tjetër.

NENI 5

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E HUAMARRËSIT

- 5.1 “Huamarrësi” ka të drejtë që sipas legjislacionit në fuqi të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me huapërdorje dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.
- 5.2 “Huamarrësi” ka për detyrë që të përdorë pronën objekt i kësaj kontrate për qëllimin e destinacionit të parashikuar në nenin 2.
- 5.3 “Huamarrësi” detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.
- 5.4 “Huamarrësi” në përfundim të kësaj kontrate ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë. “Huadhënësi” nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga “huamarrësi”.
- 5.6 “Huamarrësi” nuk i lejohet që në pronën e dhënë me huapërdorje t’ia japë me nënpërdorje ose t’ia kalojë kontratën një tjetri.
- 5.7 “Huamarrësi” është i detyruar të përdorë pronën me afat kohor njëvjeçar, dhe mbi këtë afat, nëse prona nuk i duhet bashkisë për ushtrimin e funksioneve të veta.
- 5.8 “Huamarrësi” është i detyruar të ruajë pronën me përkujdesje normale sikur të ishte pronë e tij.

NENI 7

ZGJIDHJA E KONTRATËS

- 7.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në nenin 3.1 të kësaj kontrate.
- 7.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:
 - a. Në marrëveshje midis palëve.
 - b. Kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore.
 - c. Kur prona i duhet Bashkisë për interes publik.
- 7.3 Në rast se huamarrësi nuk e dorëzon vullnetarisht objektin brenda afatit të sipërcituar, huadhënësit i lind e drejta e lirimit të ambjentit.

NENI 8

DISPOZITAT E FUNDIT

- 9.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë i referohet dispozitave të Kodit Civil në fuqi.
- 9.2 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me

mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës.

NENI 9

Kjo kontratë është formuluar në tre kopje origjinale. Një e mban huamarrësi, dy huadhënësi.

HUAMARRËS
QENDRA MUZEORE DURRËS (QMD)

DREJTOR
Alban Ramolita



HUADHËNËS
BASHKIA DURRËS
PËRFAQËSUAR NGA
KRYETAR
Emiriana Sako





BASHKIA DURRE
20/7/22 Nr. 6051/5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRE

Nr. 570/prot.
7

Durrës, më 19.07.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRE**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRE**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.77 datë 12.07.2022 Për miratimin për dhënie në përdorim pa kunsërshpërblim, Qendrës Muzeore Durrës(QMD), të pronës me emërtimin “Vendstrehim” me vendndodhje në Lagjen Nr 1 Rr “Tasulantia”, me sipërfaqe të përgjithshme 155 m2, në inventar të ndërmarjes Rruga, pronë e Bashkisë, për një afat 1 vit, me të drejtë përsëritje.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

